

## **Skujja e universitetit tonë (botuar në “Koha Ditore” më 18 shkurt 2011)**

Ngjarjet e fundit në Universitetin e Prishtinës, fatkeqësisht, spikasin pandërmjetshëm vetëm një simptomë më të dukshme të krizës së thellë dhe shumë-dimensionale me të cilën po përballet ky institucion.

Është evidente se UP-ja i ka punët keq kur një reagim instinktiv i rektorit del të jetë më i matur se reagimi i tij i gjetëmenduar. Përderisa mbahej ceremonia e shënimit të 41 vjetorit të UP-së, Rektori, prof. dr. Rugova, u ngjyros me të kuqe nga dy studentë. Reagimi i tij dinjitoz ishte shembull për studentët e UP-së se si në një demokraci, të cilën po mëtojmë ta ndërtojmë, pranohet me gjakëftohhtësi mendimi i kundërt, edhe kur ai shprehet në mënyrë joadekuate.

Çdo reagim tjetër i mëvonshëm, do të duhej të ishte i matur dhe i bazuar në argumente, qoftë nga rektori dhe organet e trupat e tjera punuese në universitet, qoftë nga qarqet e tjera jashtëuniversitare, të opinionit institucional, partiak e qytetar. Por, pa kaluar 24 orë, i njëjti udhëheqës i asaj që nganjëherë quhet tempulli ynë i dijes, e dha një mosshembull për të gjithë kosovarët, duke mos kursyer gjuhë të pahijshme pikërisht ndaj studentëve të universitetit që ai vetë e udhëheq. Ky është shembull për të keq, për shumë të keq, e edhe për më shumë keqardhje.

Simbolizmi i protestës së dy studentëve, të identifikuar si aktivistë të Partisë Vetëvendosje, mbeti i zbehtë dhe i papërshtatshëm sidomos për dy arsye. Së pari, ata nuk qenë në gjendje të argumentojnë qartë e fuqishëm pakënaqësitë dhe kërkesat e tyre. Ende mbetet e paqartë se për çfarë saktësisht u protestua dhe cilat janë kërkesat e studentëve. Për më tepër, partia politike në fjalë nuk u distanca nga ky akt i dënueshëm, duke e lënë të kuptohet se është prapa tij, gjë që është ndërhyrje politike e padenjë në një universitet.

Pikërisht politika e ka fundosur cilësinë në UP dhe e ka dobësuar tej mase rolin prijtar të këtij universiteti në shoqërinë tonë. Fillimisht ishte politika e apartheidit e viteve 90-ta, e ushtruar ndaj nesh që na detyroi ta sakrifikojmë cilësinë për të mbijetuar. Tani është politika e partive tona, e disa prej tyre më shumë se e të tjerave, të cilat vazhdojnë ta sakrifikojnë cilësinë e mësimdhënjes së UP-së, por tash në këmbim të kontrollit jodemokratik ndaj këtij institucioni.

Komandimi i UP-së dhe mikromenaxhimi i tij bëhet jo për të siguruar efikasitet e rezultate, por për favore politike, grupe ose personale. Kjo vihet në pah nga përcaktimi i numrit të

studentëve pa i ofruar atyre kushte elementare për studim, emërimi ose promovimi i stafit akademik jo gjithmonë i bazuar në zotësi profesionale, e deri te dhënia e titujve në kundërshtim me integritetin bazik akademik. Këshilli Drejtues i Universitetit, me të drejtë e dënoi sulmin e panevojshëm ndaj rektorit. I njëjti organ universitar mbetet plotësisht i heshtur kur rektori i ofendoj, po qyqarisht, studentët e vet.

Nuk do të merrem kësaj radhe me kredibilitetin e cunuar të personave që emërohen nga politika ditore për të udhëhequr një institucion arsimit ose me aftësinë e munguar udhëheqëse të po të njëjtëve, por ky është problem fundamental në universitetin publik në kryeqendër, e rrjedhimisht në tërë arsimin e lartë. Andaj, ky problem duhet adresuar dhe meriton të ngritet nga jo dy, por të gjithë studentët, si dhe stafi i UP-së.

Duke përdorur gjuhë ksenofobe, Rektori i UP-së e theu Nenin 6 të Statutit të UP-së, i cili, ndër të tjera, thotë se “Universiteti obligohet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë, pa asnjë lloj diskriminimi [...] ngjyre, gjuhe, religjioni, besimi politik a diç tjetër, përkatësi kombëtare, etnike ose sociale [...]” Prandaj, përderisa dy studentët e paguan aktin e vet të pamatur me paraburgim, rektori duhet ta paguajë aktin e vet të pamatur duke e rishqyrtuar angazhimin e tij në pozitën menaxheriale në UP dhe duke u bërë edhe një herë shembull se ai i pranon normat elementare të demokracisë, jo vetëm kur i skuqet trupi, por edhe kur thotë gjëra të cilat e bëjnë shumicën prej nesh të skuqemi në fytyrë.

Ne shqiptarët e Kosovës, me shekuj patëm problem për ta siguruar ekzistencën fizike apo mbijetesën. Për këtë mbijetesë, përveç atyre që u flijuan me jetë dhe me burgje, ka meritë të madhe edhe universiteti i jonë. Kjo duhet parë në rrafshin shkencor-sociologjik. Dija është fuqi, thonë shumë popuj në botë. Pra, universiteti ynë, përveç tjerash, në rrafshin e mbijetesës na fuqizoi shumë. Falë këtij fuqizimi, shqiptarët u ngritën për lirinë e tyre, si atribut që i tejkalon kordinatat e mbijetesës.

Lufta jonë çlirimtare dhe periudha pas saj kanë krijuar një natyrë të re në Kosovë. Këtë natyrë të re e ka kauzuar çlirimi nga okupatori dhe lidhja me botën perëndimore. Tash gjërat lindin dhe jetojnë vetëm nëse janë adekuate me këtë natyrë, në pikëpamje të progresit. Në këtë kuadër duhet observuar edhe UP-në tonë. Madje, duhet observuar me kritere më rigorozë sesa sferat e tjera, të natyrës politike ose ekonomike-zhvillimore. Në instancën e fundit, të gjitha transformimet fillojnë prej kokës. Koka është universiteti.

Konstatimi real nga brenda (introspektiv) i universitetit, në kuptimin fizik (objektet dhe pajisjet) dhe intelektual (niveli i dhënies dhe marrjes së dijes), nuk e kënaq askënd që e don një Kosovë më të përparuar. Krijimi i dy opinioneve, njëri së gjendja është e kënaqshme dhe tjetri se është e pakënaqshme, më pak është pasojë e diferencave në shkallë të njohjeve, ndërsa më shumë është pasojë e interesave të ndryshme. Rektori, në këtë rast, derisa mos të jetë më i zëshëm për ndryshimin e gjendjes, taborrizohet me grupin e atyre që janë të kënaqur me gjendjen në universitet. Dhe ngjyrosja nuk ka asgjë personale.

Dy studentët tanë nuk reagojnë në mënyrë adekuate në përvjetorin e universitetit. Mënyrat e pakënaqësisë shprehen në formën adekuate, me mjete adekuate dhe në kohën adekuate. Format e reagimit duhet t'i përgjigjen "natyrës së re". Rektori gjatë aktit të skuqjes dhe gjatë tërë ceremonisë, reagoi konform natyrës së re. Ndërkaq as ai, fatkeqësisht, pas disa kohe, nuk mundi t'i qëndrojë atij reagimi.

Universiteti i Prishtinës i ka kontribuar zhvillimit të gjithëmbarshtëm shoqëror, duke funksionuar edhe në periudha të vështira dhe duke e ndihmuar e duke i prirë rezistencës sonë, si dhe angazhimit për liri. Tash është koha që edhe një herë i njëjti institucion të orientohet me kontribut, nga studentët, stafi dhe udhëheqësit, drejt përparimit të vendit tonë. Ky kontribut fillon me përgjegjësi të të gjithëve, përfshirë studentët dhe profesorët.